

**REZYME MBI TEZËN E NIVELIT MASTER NË POLITIKË
NDËRKOMBËTARE**

**RAPORTET TURQI-BE, NË RRETHANAT PAS BREXIT-IT DHE KRIZES SË
REFUGJATËVE NË SIRI**

NGA

YLBER DELIJA



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE**

Prishtinë
Prill, 2021

RAPORTET TURQI-BE, NË RRETHANAT PAS BREXIT-IT DHE KRIZES SË REFUGJATËVE NË SIRI

Mentor: Prof.Dr. Ibrahim Gashi

Marrëdhëniet Turqi-BE, kjo romancë e datuar që nga korriku i vitit 1959, ka kaluar nëpër një periudhë ku, procesi i bashkimit të këtyre dy strukturave, proces ky që ende nuk e ka gëzuar fundin e tij, ka pasur ngjitje dhe zbritje. Marrëdhëniet Turqi-BE, që kanë ardhur gjer më sot duke kaluar nëpër një proces afro dyzetvjeçar, janë si vazhdimi reflektuar në periudhën moderne dhe që paraqesin vazhdimësi të marrëdhënieve turko-evropiane me thellësi historike jashtëzakonisht intensive.

Faktori më themelor i cili pengon kuptimin e marrëdhënieve BE-Turqi me të gjitha aspektet, me përfshirje të gjerë e të thellë, është metoda që ndiqet në përpjekjet lidhur me analizën e kësaj marrëdhënieje. Vështrimi i kësaj marrëdhënie midis një qendre që kërkohet dhe një kandidati që kërkon, si dhe interpretimi i saj në këtë kornizë, sjell me vete problemin e tri metodave themelore. E para, kjo formë e marrëdhënieve mbështetet në supozimin e dy strukturave statike. Kjo formë trajtimi që duket si e drejtë kur e ngrijmë rrjedhën historike dhe i bëjmë një fotografi, i lë mënjanë si procesin dinamik që janë duke e përjetuar BE dhe Turqia, ashtu edhe elementët dinamikë që burojnë nga vetë marrëdhënia midis këtyre dy strukturave. Prandaj, marrëdhëniet BE-Turqi nuk janë marrëdhënie të dy strukturave statike, nga të cilat, njëra kërkon ndërsa tjetra kërkohet, por marrëdhënie të dy strukturave dinamike të cilat e ripërtërijnë vazhdimisht veten.

As BE, as dhe Turqia nuk i zhvillojnë marrëdhëniet me njëra - tjetrën në një boshëllëk ku ndodhen vetëm dy aktorë dhe ku këta dy aktorë i kanë pranuar në mënyrë reciproke kushtet e një marrëdhënie njëkahëshe. Ndërsa BE i trajton marrëdhëniet me Turqinë së bashku me faktorët globalë, kontinental dhe zonalë, edhe Turqia ua reflekton marrëdhënieve ndikimet e të njëjtëve aktorë. Ndikimi i marrëdhënieve dypalëshe midis Turqisë dhe Gjermanisë mbi ecurinë e rrjedhës së marrëdhënieve BE-Turqi, është jashtëzakonisht i qartë.

Strukturalisht, ky punim është i organizuar mbrenda katër kapitujve, ku secili prej tyre përmban disa sythe ku elaborohen nëntema brenda kapitullit përkatës. Punimi provon të shtjellon Raportet Turqi-BE, në rrethanat pas Brexit-it dhe krizes së refugjatëve në Siri.

Në kapitullin e parë: do të trajtojë një kronologji të marrëdhënieve Turqi-BE dhe historikun e tyre. Me forcimin e pozitës politike të Turqisë dhe me pranverën arabe dalin në pah divergjenca të mëdha të brendshme në vendet e Bashkimit Evropian të cilat do të reflektohen në trajtimin e krizës së refugjatëve, dhe në marrëdhëniet me Turqinë. Marrëdhëniet BE-Turqi mund të trajtohen në pesë korniza të veçanta të përbëra nga rrafshet diplomaci, strukturë ekonomike - sociale, e drejtë juridike, strategji dhe qytetërim - kulturë, dhe në atë mënyrë që të përmbajnë edhe dimensionet kohë dhe metodë që i kërkojnë domosdoshmërisht këto korniza.

Në kapitullin e dytë: do të trajtoj rritjen e ndikimit të Turqisë në Ballkan dhe përdorimi i këtij ndikimi në marrëdhëniet mes dy strukturave (Turqi-BE). Rritja e forcës dhe ndikimit të Turqisë mbetet e dukshme megjithatë prap lojtarët kryesorë janë SHBA përmes forcës së saj stabilizuese dhe BE. Bashkimi Evropian mbetet si pika kryesore e strategjisë politike të jashtme të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe elitat politike si nga pozita ashtu edhe opozita janë të njëzëri në këtë çështje.

Poashtu në këtë kapitull do të trajtohet dyndja e refugjatëve Sirian drejt Evropës, dyndje kjo të cilën Turqia e shfrytëzon si kartë strategjike ndaj BE-së. Shkaku i migrimit të parregullt detyroi shtetet e Bashkimit Evropian që të arrijnë marrëveshje me Turqinë për ndalimin e migrimit ilegal të refugjatëve nga Turqia në BE. Marrëveshja mes Bashkimit Evropian dhe Turqisë mbeti në disa pika e pazbatuar në praktikë. Turqia nuk përfitoi liberalizimin e vizave që iu premtua dhe poashtu protestuan në moskryerjen e obligimeve në çështjen e pagesës siç ishte parapar në marrëveshjen për refugjatë. Padyshim që rolë kyq në këtë aspekt ka ngritja e së djathtës ekstreme, populistët e shfrytëzuan krizën për ta paraqitur veten si mborjtës të qytetërimit dhe shoqërive perëndimorë.

Në kapitullin e tretë: do të trajtohet ndikimi i Britanisë së Madhe në marrëdhëniet Turqi-BE, pas daljes të saj nga Bashkimi Evropian. Interesi i Britanisë për të mos e lënë Rusinë cariste të dilte në ujërat e Mesdheut ishte pika kyqe ku lidheshin interesat e Britanisë me ato të Osmanëve. Britania njihet si aleati kryesor dhe me i afërt që advokonte anëtarësimin e Turqisë në BE. Arsyet e një qëndrimi të tillë pozitiv sipas Britanisë ishin në kundërshtim me qëndrimin e Brukselit zyrtar.

Benifitet që do ti përfitonte Evropa nga anëtarësimi i Turqisë sipas Britanisë janë të shumta, për shembull Turqia do ti jepte një shtytje ekonomisë evropiane për shkak të tregut të madhë që posedon dhe popullsisë së re. Bashkimit Evropian me humbjen e Britanisë i duhet mbrojtja e NATO-s më shumë se kurrë, pasi Britania doli, BE-ja humbi njëren nga kontigjentet më të mëdha ushtarake që posedonte, kjo gjendje e re e vën Turqinë në ballë të luftës të sigurimit të interesave për aleancën Veriatlantike.

Në kapitullin e katërt: do të trajohet evolimi i marrëdhënieve të Turqisë me Evropën, duke përfshirë marrëdhëniet pas luftës së ftohët si dhe marrëdhëniet në ditët e sotme mes këtyre dy strukturave. Marrëdhëniet Turqi-BE në vetvete përbëjnë një dilemë e cila haset rrallë në histori. Në të kaluarën Perandoria Osmane për 6 shekuj mbajti sundimin në një pjesë të kontinentit dhe deri në vitin 1683 ishte rreziku kryesor për sigurinë evropiane. Pra marrëdhënia Turqi-BE, apo kandidatura e Turqisë për integrim në BE nuk është thjesht sikurse e një shteti evropian aspirues për të qenë pjesë e unionit dhe anëtarëve të tij, përplasjet kulturore dhe historike e bëjnë këtë marrëdhënie të jashtëzakonshme në sensin e afërsisë gjeografike dhe largësisë kulturore që përceptohet nga qarqe politike të të dy anëve.

Shtjellimi i temës na bie në përfundimin e pashmangshëm, Turqia mund të konsiderohet aleate, partnere, kandidate etj, por në sytë e evropianëve nuk është pjesë e Evropës. Siç shihet marrëdhëniet mes dy strukturave Turqi-BE, janë në një udhëkryq, por siç e përfundon Henry Kissinger librin e tij “Diplomacia” me një proverb spanjoll “Udhëtar rrugët nuk kanë ekzistuar, ato janë formuar duke ecur”.